

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Luljeta Shabani dhe Venhar Salihu, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. B., nga ..., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope, nga neni 229 paragrafi 2 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës,¹ të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati A. I., nga ..., sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Gjiilan, PP.nr.263/2011, e datës 13 dhjetor 2011, të cilën e përfaqësonte prokurori Arben Kadriu, pas kthimit të çështjes në rigjykim nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës, me aktvendimin PAKR.nr.479/2015, të datës 18 prill 2016 dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 10 tetor 2016, në të njejtën datë mori dhe publikisht shpalli, kurse më datën 14 tetor 2016, e përpiloi me shkrim këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari A. B., nga babai L. dhe nëna Z., e lindur H., i lindur më datën ..., në Gj., ku edhe jeton, rruga "...", nr., shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., i martuar, babë i ... fëmijëve, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin ..., duke u bazuar në nenin 364 paragrafi 1, nënparagrafi 3 të KPP,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse kinse nga data ... 2011 deri më datën ...2011, ka poseduar dhe është marrë me shit-blerjen e substancave narkotike, ashtu që më datën ... 2011, te i akuzuari A. B., para shtëpisë së tij, në Gj., rr."...", në trup i gjenden ... paketime, të llojit "...", në peshë prej ... gramë, të cilën e kishte blerë nga i akuzuari Sh. B., për çmimin prej ... Euro dhe në shtëpinë e të akuzuarit Sh. B., më datën ... 2011, gjatë bastisjes janë sekuestruar ... kavanoza, me substancë narkotike, të llojit "...", në peshë prej ... gramëve, ... peshore elektrike dhe në xhep të pantallonave ... Euro dhe të njejtit nga Policisa e Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve në Gjiilan, arrestohen,

-me këtë kishte për të kryer veprë penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 paragrafi 2 lidhur me nenin 23 të KPK.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit "...", në sasi prej ... gramëve.

Shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

¹ Kodi i Penal i Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPK) - Rregullorja e UNMIK-ut, nr.25/2003, e datës 6 korrik 2003.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës dhe dhe fjala përfundimtare

Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan, më datën 13 dhjetor 2011, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarve Sh. B., nga fshati V., Komuna e V. dhe A. B., nga ..., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni 229 paragrafi 2 lidhur me nenin 23 të KPK.

Me aktgjykimin e Gjykatës themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.27/2012, të datës 4 nëntor 2013, i akuzuari Sh. B., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të lartcekur, sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe ndaj tij është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë muajve) dhe dënimi me gjobë në shumë prej 500 Euro. Gjithashtu, me këtë aktgjykim edhe janë konfiskuar ... kavanoza me substancë narkotike e llojit "...” në sasi prej ... gramëve: ... peshore elektrike dhe shuma e të hollave prej ... Euro.

Ndërsa, ndaj të akuzuarit A. B., ishte veçuar procedura penale, për shkak se i njëjti nuk e kishte pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Pas kësaj, kryetari i trupit gjykues e kishte caktuar shqyrtimin gjyqësor dhe pas administrimit të provave, i akuzuari A. B., me aktgjykimin e kësaj Gjykate, PKR.nr.647/2016, të datës ... 2015, ishte liruar nga akuza.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PAKR.nr.479/2015, të datës 18 prill 2016, e kishte pranuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda dhe këtë çështje penale e kishte kthyer në rigjykim.

Pas kthimit të kësaj çështje në rigjykim, përsëri është caktuar shqyrtimi gjyqësor dhe pas administrimit të provave, prokurori i shtetit Arben Kadriu, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare që e kishte deklaruar gjatë seancës së mëparshme të shqyrtimit gjyqësor.

I akuzuar A. B. dhe mbrojtësi i tij, avokati A. I., gjatë fjalës përfundimtare i kanë propozuar trupit gjykues që i akuzuari të lirohet nga akuza.

2. Konstatimet e trupit gjykues

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, trupi gjykues konstatoi këtë gjendje faktike:

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari A. B., me dashje dhe me qëllim të shitjes, shpërndarjes ose ofrimit për shitje e ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, nga neni 229 paragrafi 2 lidhur me nenin 23 të KPK, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

3. Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Gjendjen faktike të lartëcekur, trupi gjykues e konstatoi pas administrimit të këtyre provave:

- leximin e deklaratave e dëshmitarëve E. M. dhe ...A. C., të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 2 shtator 2015;²

- leximin dhe shikimin e provave materiale, siç janë : fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës; vërtetimet mbi konfiskimin e substancave narkotike; raporti i ekspertizës dhe raportet mjekësore si dhe

- marrjen në pyetje të akuzuarit A. B..

3.1. Deklaratat e dëshmitarëve

3.1.1. Dëshmitari E. M., oficer i Policisë së Republikës së Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve në Gjilan, gjatë marrjes në pyetje në seancën e shqyrtimit të kaluar gjyqësor, ka treguar se cilat veprime hetimore i ka ndërmarrë lidhur me këtë çështje penale. I njëjti ka deklaruar pas bisedave telefonike të zhvilluara, i akuzuari A. B., kishte shkuar në fshatin V., Komuna e V., ku nga i pandehuri Sh. B., ishte furnizuar me substancë narkotike të llojit "...". Posa i akuzuari A. B., është kthyer në Gj., në hyrje të shtëpisë së tij është bërë kontrollimi i tij dhe në trupin e tij është gjetur një paketim me substancë narkotike të llojit "...", në peshë prej ... gramëve. I akuzuari A. B., kishte qenë i njohur si konsumues i substancës narkotike të llojit "...", dhe deri atëherë, Drejtoria në të cilin ka punuar dëshmitari E. M. nuk kanë patur informata se i akuzuari A. B. ka qenë shitës i substancave narkotike. Sipas dëshmitarit, një përdorues i substancave narkotike të llojit "...", mund të konsumoj deri diku në ... gram në ditë dhe gjithmonë duke u bazuar edhe në kualitetin e substancës narkotike. Edhe një herë e kishte potencuar se nuk kanë patur argumente që i ka akuzuari A. ta ketë marrë substancën e lartëcekur me qëllim shitje, ngase i njëjti ka qenë konsumues i kësaj substance narkotike. Meqë dëshmitari E. M., nuk ka marrë pjesë gjatë kontrollimit të shtëpisë, dëshmitari nuk ka patur njohuri nëse në shtëpinë e të akuzuarit A. B., është gjetur ndonjë peshore apo ndonjë mjet që e ndanë substance narkotike për ta shitur.

3.1.2. Dëshmitari ...A. C.-..., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin e kaluar gjyqësor kishte deklaruar se e njeh të akuzuarin A. B., ngase i njëjti ka qenë pacient i tij për shkak të varëshmërisë nga substancat narkotike të llojit "...", gjatë vitit 2011. Për dallim nga pacientët tjerë, i akuzuari A. B., ka pranuar që të trajtohet me një terapi më specifike, e cila ka rezultuar të jetë me e suksesshme, ku në rastin konkret ka përdorur medikamentin "...", i cili është një medikament për personat që janë më të motivuar për ta larguar varëshmërinë nga "...". Ky trajtim konsiderohet specifik dhe minimumi i këtij trajtimi është gjashtë muaj, mirëpo, kjo varet edhe nga motivimi i personit. Në fund, dëshmitari ... A. C., ka deklaruar se nuk mund të përcaktojë sasinë e konsumimit të substancës narkotike të llojit "...", ngase e njëjta vazhdimisht kërkon rritjen e dozës.

3.2. Provat materiale

² Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 10 tetor 2016, prokurori i shtetit Arben Kadriu, ka propozuar që të lexohen deklaratat e dëshmitarëve Enver Mustafa dhe Dr.Afrim Cana, të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 2 shtator 2015. Me këtë propozim janë pajtuar dhe i akuzuari A. Brestovci dhe mbrojtësi i tij, avokati Avdullah Ismajli. Trupi gjykues, pas kësaj, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, ka marrë aktvendim me të cilin e ka aprovuar propozimin e prokurorit të shtetit, ku edhe janë lezuar deklaratat e dëshmitarëve Enver Mustafa dhe Dr.Afrim Cana, ngase, me këtë propozim është pajtuar edhe mbrojtja. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, të datës 10 tetor 2016, nuk ka patur propozime për dëgjimin e dëshmitarëve tjerë.

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresa të lëndës, shihet një shtëpi, peshore, substanca narkotike, etj., mirëpo, të gjitha këto i referohen të pandehurit Sh. B. dhe nuk kanë të bëjnë me të akuzuarin A. B..

Në raportin e ekspertizës të laboratorit të Forenzikës, të datës ... 2011, shihet në substanca narkotike e cila është sekuestruar nga i akuzuari A. B. dhe nga i pandehuri Sh. B., është llojit "...", e përzier me "...".

Nga fletëlëshimi me epikrizë, Nr...., i datës ... 2011, shihet pas disa problemeve shëndetësore, ka vdekur L. B., ndërsa nga Raporti Mjekësor i Qendrës së Shëndetit Mendor në Bashkësi, i datës . 2010, shihet se i akuzuari A. B., është trajtuar tek A. C..

Nga fletëlëshimi i Qendrës Klinike Universitare, Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë, Reparti për Trajtimin e Sëmundjeve të Varësisë, nr..., i datës ... 2010, shihet që i akuzuari A. B., është pranuar në këtë Repart i motivuar për të ndërprerë përdorimin e mëtejshëm të substancës narkotike.

Si provë materiale janë administruar edhe ... vërtetime për konfiskimin e sendeve, ku njëri prej tyre i referohet sendeve që i janë sekuestruar të akuzuarit A. B.. Nga vërtetimi për konfiskimin e sendeve, i datës ... 2011, shihet se të akuzuarit A. B., nga ana e zyrtarit policor i është sekuestruar substanca narkotike e llojit "...", në peshë prej ... gram, ... telefon dhe ... veturë "...".

3.3. Deklarimi i të akuzuarit A. B.

I akuzuari A. B., gjatë marrjes në pyetje në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetëm në tërësi pranë deklaratës të cilën e ka dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës ... 2015, ku e kishte mohuar kryerjen e kësaj veprë penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ditën kritike ka biseduar përmes telefonit me të akuzuarin Sh. B.n, për tu takuar dhe për ta provuar substancën për të cilën kishte dëgjuar se e ka të llojit të mirë. I akuzuari A. B., substancën narkotike e cila është sekuestruar ditën kritike, e ka poseduar për përdorim personal, çka do të thotë se qëllimi i tij nuk ka qenë shitja ose shpërndarja e së njëjtës, ngase, si para ashtu edhe gjatë vitit 2011, e ka përdorë substancën narkotike të llojit "...". Sasia ditore të cilën e ka përdorur në atë kohë, ka qenë përafërsisht 3 gram në ditë, varësisht nga kualiteti i substancës narkotike. Arsyeja pse e ka marrë këtë sasi të substancës narkotike, qëndron se është fëmijë ... në familje dhe prindi i tij ka qenë i sëmur në atë kohë, kështu që, nuk ka pasur kush të kujdeset për të. Arsye tjetër për këtë, është fakti se i akuzuari A. B., ishte i varur nga substancat narkotike dhe i është dashur që çdo ditë të shkoj nëpër qytete të ndryshme të Kosovës për të gjetur substancë narkotike të kualitetit të mirë. Gjatë vitit 2011 ka realizuar të ardhura nga qiraja e ..., nga ... që e ka pasur ... e tij, nga pensioni i babait të tij dhe nga puna e tij si I akuzuari A. B., kishte shtuar se asnjëherë më parë nuk kam shitur dhe shpërndarë substanca narkotike.

Duke vepruar edhe sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të paraqitura në aktvendimin PAKR.nr..../2015, të datës ... 2016, i akuzuari është ballafaquar me deklaratën e tij, të dhënë para zyrtarëve policor, të datës ... 2011, ku në pyetjen e parashtuar nga ana e zyrtarëve policor se :

- "A keni shitur apo shpërndarë drogë?",
- I akuzuari ishte përgjigjur se "Jo nuk kam shitur, por ka ndodhur që tua jap ndonjë shokut me qëllim që dal nga kriza".

Lidhur me këtë, i akuzuari A. B., gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor është përgjigjur së "pari përgjigjja e shkruar është e pakuptimtë për shkak se qysh është e mundur që unë duke iu dhënë të tjerëve me dal nga kriza, ndërsa, e dyta është që ajo ka

mundur t'i referohet asaj periudhe gjatë së cilës unë kam qenë në Gj.. e edhe atje kam mundur me ja dhënë dikujt”.

I akuzuari A. B., gjithashtu ka shtuar se asnjëherë më parë nuk ka ndodhur që të blej sasi kaq të madhe të narkotikut dhe edhe një herë e ka sqaruar se arsye pse e ka blerë sasinë kaq të madhe është se që të mos të largohet nga shtëpia për shkak se në atë kohë e kishte babin e sëmurë, bile babai i tij kishte vdekur ... javë pas arrestimit – gjatë kohës sa i akuzuari kishte qenë në paraburgim për këtë rast. Çmimi i kësaj substance narkotike kishte kushtuar ...Euro.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 229 paragrafi 2 të KPK, janë parashikuar elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope, për të cilën është akuzuar i akuzuari A. B.. Sipas kësaj dispozite ligjore, këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca apo preparate të cilat janë shpallur të rrezikshëm, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje” dhe për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) deri 8 (tetë) vjet. Ndërsa, në paragrafin 1 të nenit të lartcekur, është parashikuar forma themelore e kësaj vepre penale, të cilin e kryen “Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim shitje, shpërndarje ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë dhe substancë psikotropike” dhe për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet.

5.Vlerësimi dhe analizimi i provave

Trupi gjykues pas analizimit me shumë kujdes të gjitha provave të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi i plotë deklaratës së të akuzuarit A. B., i cili e ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar. Deklarimi i të akuzuarit A. B., se substancën narkotike, e cila i është sekuestruar ditën kritike, nuk e ka patur për qëllim që ta shes, shpërndajë apo ofroj për shitje, është në harmoni të plotë edhe me deklaratat e dëshmitarëve E. M. dhe A. C.. Dëshmitari E. M., oficer i Policisë së Kosovës, Njësi Antidrogë në Gjilan, ka deklaruar se i akuzuari A. B., ka qenë konsumues i substancës narkotike të llojit “...” dhe për të nuk ka patur informata se i njëjti merret me shitjen e kësaj substance. Duke ju referuar vërejtjeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, lidhur me dëshminë e dëshmitarit E. M., trupi gjykues ka ardhur në përfundim se ky dëshmitar kur kishte deklaruar se “një përdorues i substancave narkotike të llojit ‘...’”, mund të konsumoj deri diku në ... gram në ditë dhe gjithmonë duke u bazuar edhe në kualitetin e substancës narkotike”, këtë e kishte thënë në bazë të eksperiencës së tij, për shkak se i njëjti është një oficer policor me një përvojë të gjatë në zbulimin dhe luftimin e veprave penale të kësaj natyre. Në anën tjetër, dëshmitari A. C., psikiatër, ka deklaruar se gjatë vitit 2011, i akuzuari A. B., ka qenë pacient i tij, për shkak të varëshmërisë nga substanca narkotike e llojit “...”. Se i akuzuari është trajtuar për shkak të varëshmërisë nga substancat narkotike, mund të shihet edhe nga raportet mjekësore, të cilat janë administruar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Trupi gjykues i ka analizuar me shumë kujdes deklaratat e dëshmitarëve E. M. dhe A. C., si dhe të njëjtat i ka vlerësuar si deklarata bindëse, objektive, në harmoni me njëra-

tjetrën, kështu që të njëjtëve ja ka faluar besimin e plotë. Dëshmitari E. M., është një zyrtar policor me një përvojë të gjatë në Policinë e Kosovës, Njësiti Antidrogë në Gjilan, kështu që ai më së miri është njoftuar me veprimtarinë kriminale të shitjes dhe shpërndarjes së substancave narkotike në Regjionin e Gjilanit. Në anën tjetër, A. C., është përndryshe edhe ekspert gjyqësor, në fushën e tij dhe ka një përvojë të gjatë në trajtimin e sëmundjeve psikiatrike, në kuadrin e cilës trajtohen edhe personat që janë të varur nga substancat narkotike. Po ashtu, deklarimi i dëshmitarit A. C., gjen mbështetje edhe në raportet mjekësore, të cilat janë administruar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Përveç që është në harmoni me provat tjera, deklarimi i të akuzuarit A. B., është në harmoni edhe me deklaratat e tij të dhëna në prokurorinë Publike të Qarkut në Gjilan dhe pranë Stacionit Policor në Gjilan. Edhe në deklaratat e tij të mëparshme, i akuzuari A. B., kishte deklaruar se substancën narkotike e ka blerë me qëllim të konsumimit për vete dhe nuk e ka patur për qëllim që të njëjtën ta shes, ta shpërndaj apo ta ofroj për shitje. Se i akuzuari A. B., e ka patur të sëmurë babain e tij, mund të vërtetohet edhe nga raporti mjekësor që është administruar si provë materiale, si dhe nga urdhëresa e gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, PPr.nr. .../2011, të datës ... 2011 përmes së cilës i është lejuar të akuzuarit A. B., i cili ishte në atë kohë në paraburgim, që të marrë pjesë në varrim të babait të tij. Në anën tjetër, përveç këtyre që janë cekur më lart, në shtëpinë e të akuzuarit A. B., nuk është gjetur ndonjë peshore, qese apo mjet i cili shërben për ndarjen dhe përgatitjen e substancave narkotike për t'u shitur ose shpërndarë.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u cekën më lart, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se nuk është vërtetuar se i akuzuari A. B. e ka patur për qëllim që substancën narkotike e cila i është sekuestruar ditën kritike, që ta shes, ta shpërndaj apo ta ofrojë për shitje dhe se qëllimi i tij ka qenë që atë substancë narkotike ta konsumojë për nevoja të veta personale. Kurse, në anën tjetër, duke u bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPK, për të ekzistuar kjo formë e kësaj vepre penale, duhet që veprimi i kryerjes të ndërmerret me qëllim shitje, shpërndarje ose ofrimi për shitje (“...”) dhe të gjitha këto veprime duhet të ndërmerren pa autorizim. Me fjalë tjera, për të ekzistuar kjo formë e kësaj vepre penale duhet që “kryesi pa autorizim të blejë ose posedoj me qëllim shitje ose shpërndarje substanca apo preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë dhe substancë psikotropike, ose ti ofrojë për shitje këto substanca”. Pra, qëllimi i cekur më lartë, është element esencial apo themelor i kësaj forme të veprës penale. Gjithashtu edhe për të ekzistuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, nga neni 229 paragrafi 2 të KPK, për të cilën është akuzuar i akuzuari A. B., duhet që kryerësi pa autorizim të shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca apo preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje.

6. Vendimi për lirimin e të akuzuarit nga akuza

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë dhe nenin 364, paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP, trupi gjykues e liroi nga akuza të akuzuarin A. B., për kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, nga neni 229 paragrafi 2 lidhur me neni 23 të KPK.

7. Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike

Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 282 paragrafi 1 nënparagrafi 2.4 të KPP, ka vendosur që ta konfiskojë substancën narkotike të llojit "...", në peshë prej ... gramëve, për shkak se kjo substancë narkotike është qenësish e rrezikshme dhe posedimi i saj është i paligjshëm.

8. Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar në nenin 454 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur sinë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 14 tetor 2016

Sekretare juridike,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të të njejtit. Andeksa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.